

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE 14 TETOR 2021

E nderuar, zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa dyshim, shqyrtimi i dekretëve të Presidentit të Republikës për kthimin e ligjeve në Kuvend dhe debati për argumentet e paraqitura, si një praktikë normale e punës së Kuvendit, është një opurtinitet jo thjesht për kundërvënie, siç ndodh rëndom, por për një debat profesional dhe të argumentuar, që produkti i punës të jetë një ligj sa më koherent, sa më funksional dhe i zbatueshëm, e mbi të gjitha, në të mirë të qytetarëve dhe në të mirë të vendit. Mendoj se qëndrimi ndaj dekretit të Presidentit është një provë për gjithsecilin prej nesh, për të kuptuar se kush punon që shqiptarët të qëndrojnë në Shqipëri e të ndërtojnë të ardhmen e tyre këtu, dhe kush punon që t'i largojë e t'i zëvendësojë qytetarët shqiptarë me qytetarë nga Bangladeshi. Me këtë ligj qeveria krijon lehtësira të jashtëzakonshme për shtetasit e huaj. Kjo do të përshëndetej, pa dyshim, nëse kjo qeveri do t'u kishte krijuar kushte dhe mundësi mijëra të rinjve, dhe jo vetëm, të cilët përballen sot me dyert e mbyllura të punësimit dhe të mundësive të mira profesionale, të konkurrencës së ndershme bazuar në konkurrencë, meritokraci dhe shanse për karrierë. Sot Shqipërinë tonë duan ta lënë jo vetëm të rinjtë, por edhe qytetarë me të ardhura të mira financiare, profesionistë të zotë, të cilëve u mungon shpërblimi, sepse vendi ynë nuk ofron mundësi punësimi, siguri dhe mirëqenie. Kjo dramë na sjell një tjetër, edhe më të madhe, atë të shpopullimit. Këto nuk janë fjalë, por fakte të bazuara në shifra.

Shqipëria zë vendin e parë në Europë për numrin e azilantëve ekonomikë, duke lënë pas edhe vende të sapodala nga lufta dhe nga konfliktet civile. Sipas të dhënave të Eurostat-it, në muajin korrik arritëm numrin rekord të kërkesave për azil, plot 735 kërkesa vetëm nga Shqipëria, niveli më i lartë që nga fillimi i pandemisë, duke qenë serish të parët në rajon. Ndonëse me masa kufizuese dhe me kufij pothuajse të mbyllur, shqiptarët janë përpjekur me të gjitha mënyrat të largohen jashtë vendit, duke zënë vendin e parë në Europë edhe për vitin 2020 për numrin e aplikimeve për azil nga Ballkani dhe vendin e dytë në botë, pas Sirisë, në raport me popullsinë. Çfarë janë këta që po ikin? Po largohet truri, rinia, duke i hapur vendit tonë një plagë të madhe. Në një anketë të Qendrës për Studime Ekonomike dhe Sociale rezultoi se rreth 80% e studentëve shqiptarë dëshirojnë të largohen nga vendi. Sipas Institutit për Studime Ekonomike Ndërkombëtare të Vjenës, nga viti 2010 deri në vitin 2019, janë larguar nga Shqipëria rreth 500 mijë qytetarë, disa herë më shumë në krahasim me rajonin. Të dashur kolegë, Këto nuk mund t'i quajmë thjesht si fenomene mbarëbotërore, që ndodhin kudo. Vendi ynë ka treguesit më të lartë në Europë dhe në rajon për sa i përket mosarsimit dhe mospunësimit të rinisë. Largimi i trurit dhe i forcave të reja më krijuese të shoqërisë duhet ndalur sa më parë. Të rinjve tanë u duhet ofruar më shumë shpresë, më shumë alternativa edukimi dhe punësimi, ndërsa të arsimuarve, më shumë shanse të barabarta, vlerësim meritokracie për vende pune, ku të shfaqin talentin dhe potencialin e tyre intelektual. Mbyllja e perspektivës për të rinjtë është rrënja e shpopullimit të Shqipërisë. Me këto ritme dramatike, zbrazja e Shqipërisë rrezikon të kthehet në një fatkeqësi kombëtare. Adresimi i menjëhershëm i këtij fenomeni është emergjent dhe çdo neglizhencë e mëtejshme do të sjellë pasoja katastrofike. Mendoj se duhen shumëfishuar përpjekjet e të gjithë

aktorëve jo vetëm për t'i thënë "ndal" shpopullimit, por për të krijuar programe konkrete dhe realiste, që u krijojnë mundësi më të mira qytetarëve, sidomos të rinjve. Kanosja e Kryeministrit fill pas miratimit të këtij ligji, që shqiptarët do të zëvendësohen me krahë të lirë pune, me punëtorë nga vende të botës së tretë, si: Bangladeshi dhe India; ironia e tij se "sa me pak shqip të dinë, më mirë është, sepse merren më pak me thashetheme", është tregues i qartë i mënyrës se si kjo qeveri dhe ky kryeqeveritar u qasen problemeve që kërkojnë zgjidhje. Qytetarët duan siguri, punësim dhe mirëqenie. Sot ka familje që nuk sigurojnë dot para për shpenzimet mujore; ka familje që nuk arsimojnë dot fëmijët; ka të rinj që nuk ndjekin shkollën, dhe zgjedhin arratinë për shkak të varfërisë. Kjo nuk është fantazi. Ky është realiteti mjeran shumë i dhimbshëm për të gjithë ne. Kjo situatë kërkon vëmendje maksimale dhe marrjen e masave urgjente nga qeveria dhe nga të gjitha autoritetet shtetërore, për të ndërtuar një strategji të qartë, efektive dhe kombëtare, që lufton realisht dhe në mënyrë të vazhdueshme fenomenet, që çojnë në braktisjen e vendit nga shqiptarët. Këtë shpopullim qeveria nuk e llogarit fare si shqetësim, nuk e adreson dhe as nuk krijon plane apo programe për lehtësim dhe zgjidhje. Në programin e qeverisë nuk u pa e udhës të shkruhej asnjë rresht për këtë fenomen, as se si do të mbahen të rinjtë dhe profesionistët në këtë vend, as se si do t'u rritet mirëqenia punëtorëve dhe familjeve. Pa dyshim ka lajme të reja, por te këqija: çmimet, që nuk e ndalin rritjen në produktet e shportës, të bukës, të karburantit dhe të gazit.

Të dashur kolegë, Ne duhet të kemi një qasje profesionale dhe vullnetin që puna jonë si deputetë të jetë kontribuese dhe jo refraktare, vetëm e vetëm se Presidenti, i cili e ka kthyer ligjin, është dikush që nuk e duam dhe nuk na pëlqen. Gjykoj se ka argumente të mjaftueshme për ta konsideruar argumentimin e kthimit si një mundësi për ta përmirësuar ligjin. Kjo është edhe një dëshmi e seriozitetit të punës së të gjithëve ne. Le t'u provojmë qytetarëve se Kuvendi ka sensin e përgjegjësisë dhe të seriozitetit në përmbushjen e misionit të vet. Faleminderit!